



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Datë: 08.05.2025

Numër protokoli: 3087/2025

A.nr.472/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Flakron Gashi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurë sipas ankesës me numër A.nr.472/2025, të datës 14.03.2025, të parashtruar nga ankuesi M.I, nga Obiliqi, kundër organit të punësimit/Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike “*kërkesë nga marrëdhënia e punës*”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180 si dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 08.05.2025, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.472/2025, e datës 14.03.2024, e parashtruar nga ankuesi M.I.

A r s y e t i m

Nëpunësi civil, M.I. (në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesi), me datë 14.03.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar nën shenjë A.nr.472/2025, kundër mosveprimit të organit të punësimit lidhur me zbatimin e Vendimit të datës 20.11.2024 dhe Aktit të Emërimit të datës 21.11.2024, përmes të cilave akte ankuesi ishte transferuar në pozitën Zyrtar i Lartë për Përkthime.

Kryetari i Këshillit me datë 25.04.2025 ka nxjerrë Vendimin me shifër VK/2025 dhe numër protokoli:2760/2025, përmes të cilit ankesës së ankuesit nën shenjë A.nr.472/2025 të datës 14.03.2025 ia ka vazhduara fatin e vendimmarrjes edhe për dhjetë (10) ditë të tjera, ditë pune.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datën 17.03.2025 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Obiliqit si dhe me datë 28.04.2025 janë kërkuara sqarime dhe prova shtesë, ndërsa kjo e fundit, me datë 20.03.2025, ka

dorëzuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës, si dhe me datë 02.05.2025 ka dhënë prova dhe sqarime shtesë sipas kërkesës së Këshillit.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejshëm referuar: Kolegji i Këshillit) për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 1714/2025 e parashtruar nga ankuesi më datën 14.03.2025 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit të ankuesit; Vendimin e datës 20.11.2025 të kryetarit të Komunës; Akt emërimit të datës 21.11.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 17.03.2025; Përgjigje në ankesë e datës 20.03.2025; Formular i datës 08.01.2025; Formulari i datës 05.12.2024; E-mailin e datës 12.03.2025 dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore tek DMZP; E-mailin e datës 17.01.2025 dhe 21.02.2025 dërguar nga A.T për A.M me korrespondencën e bashkangjitur; Emailin e datës 02.05.2025 dërguar nga A.M për Këshillin; Ndryshimin dhe plotësimin e Akt të Emërimit të datës 24.02.2013; Kërkesa për transferim e datës 11.11.2024; Diploma e ankuesit e datës 17.11.2014; vendimi datës 29.06.2022 për për aprovimin e rregullores për organizmin e brendshëm; Rregullorja 04/2022 me shtojcën dhe Organogramin e bashkangjitur;

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lindës të ofruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses, është e **pabazuar**, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës, Kolegji i Këshillit konstatoi se ankuesi sipas Ndryshimit dhe Plotësimit të Aktit të Emërimit të datës 24.02.2013 është i punësuar në Komunën e Obiliqit, në pozitën “Përkthyes shqip serbisht dhe anasjelltas” me koeficient të pagës 7.5 sipas ligjit të vjetër të pagave, në kuadër të Drejtorisë së Administratës. Me datë 11.11.2024, Udhëheqësi i tij i drejtpërdrejtë ka kërkuar që ankuesi të transferohet në mënyrë të përhershme në interes të institucionit në pozitën Zyrtar i Lartë për Përkthime, ndërsa Kryetari i Komunës së Obiliqit me datë 20.11.2024 ka nxjerrë Vendimin Nr.02-110-03-35969-24 përmes të cilit ankuesi është transferuar në mënyrë të përhershme në pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Përkthime”, në kuadër të Drejtorisë së Administratës, dhe më pastaj Njësia e Burimeve Njerëzore me datë 21.11.2024 i ka lëshuar Akt Emërimit Nr.02-110-03-36127-24 përmes të cilit emërohet në pozitën përkatëse, kategoria Profesional 1, dhe koeficient të pagës 5.58.

Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Obiliqit, me datë 05.12.2024 dhe me datë 08.01.2025 i ka përcjellë formularët për ndryshim në listën e pagave në Thesarin e Kosovës, ndërsa me datë 21.02.2025 Divizioni i Pagave në Thesarin e Kosovës, ndryshimin e pagës për ankuesin nuk e kanë aprovuar me arsyetimi, **citoj:** “Gjatë kontrollit të lëndës është vërejtë se institucioni i juaj nuk e keni sjellë Rregulloren e Brendshme për Sistematizimin e Vendeve të Punës, prandaj për tu proceduar tutje këto lëndë duhet të bëhet përmes rregullores së brendshme për sistematizimin e vendeve të punës”.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se organi i punësimit nuk është duke i zbatuar aktet të cilat vetë i ka nxjerrë, gjegjësisht nuk po i zbaton Vendimin e datës 20.11.2024 dhe Aktin e Emërimit të datës 21.11.2024, me kërkesën që Këshilli të aprovoi ankesën e tij dhe ta detyroi organin e punësimit që të njëjtit t’ia kompensoi diferencën në pagë ndërmjet koeficienteve apo klasës, dhe atë që

nga momenti i transferimit të tij në pozitën Zyrtar i lartë për Përkthime, me specifikacionin se vetëm edhe 2 apo 3 zyrtar kanë mbetur pa ju korrigjuar koeficienti.

Këshilli me rastin e dërgimit të kërkesës së datës 17.03.2025 për përgjigje në ankesën e ankuesit si dhe dërgimin e kërkesës së datës 28.04.2025, ndër të tjera kishte kërkuara edhe provat apo dëshmi me sqarime si në vijim: *“Dëshmi nëse organi i punësimit/Komuna e Obiliqit e ka pasur të përcaktuar me akte të brendshme pozitën Zyrtar i Lartë për Përkthime, si dhe konfirmimin nëse e njëjta pozitë ka qenë e lirë; Dëshmi nëse organi i punësimit e ka përfunduar Klasifikimin e Vendeve të punës”*, ndërsa në përgjigjet e dhëna të datës 20.03.2025 dhe 02.05.2025 nga Njësia e Burimeve Njerëzore, Këshilli është informuar se Komuna e Obiliqit e ka draftuar Rregulloren për organizmin e brendshëm dhe klasifikimin vendeve të punës, ndërsa të njëjtën me datë 15.03.2025 e ka dërguar për mendim këshillimor në Departamentin për Menaxhimin e Zyrtarëve Publik, si dhe konstaton faktin se pozita në të cilin ankuesi është transferuar dhe emëruar përmes Vendimit të datës 20.11.2025 dhe Akt Emërimit të datës 21.11.2025, është parashikuar si pozitë, mirëpo pozita nuk është e lirë, me sqarimet shtesë sipas shkresës me shifër 12-112-12-7653-25 se në momentin që rregullorja e re të aprovohet në kuvendin e komunës, Njësia e Burimeve Njerëzore përsëri do ta dërgoj lëndën në Thesar për ndryshimin e pagës së ankuesit.

Me qëllim të shqyrtimit të pretendimeve ankimorë të ankuesit, Kolegji i Këshillit mori përbazë dispozitat e nenit 65 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-197 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *‘1. Nëpunësja/i civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil. Për rastet kur nëpunësja/i civil është e nivelit drejtues të ulët, mesëm apo të lartë, transferimi sipas këtij neni bëhet për periudhën e mbetur të mandatit për të cilin është emëruar’* si dhe nenit 11 paragrafi 1 dhe 8 të Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil ku përcaktohet se: *“1. Nëpunësi civil mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në një vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit civil; 8. Arsyeimi i vendimit të transferimit të përhershëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga NjMBNj e institucionit ku nëpunësi është i punësuar.”*, dhe konstatoi se në rrethanat e përcaktuara ligjore, ligji material e ka lejuar si kategori çështjen e transferimit të përhershëm në interes të institucionit, brenda së njëjtës kategori, me kushtin që nëpunësi civil të plotësoj kriteret e pozitës së punës ku transferohet, mirëpo në rrethanat e rastit konkret, Kolegji i Këshillit thekson faktin se në secilin rast një pozitë e punës mund të plotësohet përmes procedurës së rekrutimit, apo me transferim të brendshëm thënë si më lartë, mirëpo është parakusht që pozita të jetë e lirë, prandaj ankesa e ankuesit në këtë situatë dhe nën këto rrethana juridike nuk gjen zbatim në ligjin material, pasi që organi i punësimit përmes shkresës së datës 02.05.2025 ka deklaruar se pozita në të cilën ankuesi është transferuar *“Zyrtar i Lartë për Përkthime”* nuk ka qenë pozitë e lirë, nga rrjedh se transferimi i ankuesit si dhe emërimi i të njëjtit në një pozitë e cila praktikisht nuk është e lirë, është veprim i paligjshëm.

Thënë si më lartë, Kolegji i Këshillit nga analizimi i shkresave të lëndës dhe pretendimet ankimore të ankuesit, si dhe vetë sqarimeve të dhëna nga organi i punësimit, Kolegji i Këshillit erdhi në konstatimin se qëllimi i transferimit të ankuesit, në fakt ka qenë synim i klasifikimit të pozitës së ankuesit, gjegjësisht kalimi i pozitës së tij nga klasa Profesional 2 në Profesional 1, andaj me këtë rast Kolegji i Këshillit thekson faktin se çështje të tilla trajtohen duke marrë për bazë dispozitat e aplikuara nga neni 12 i Rregullores Nr.02/2024 për Transferimin e Nëpunësve Civil, ndërlidhur me Rregulloren Nr. 06/2024 Për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, ashtu që Komuna e Obiliqit, mund t'i nënshtrohet procesit të ristrukturimit apo të organizmit të brendshëm dhe klasifikimit të vendeve apo pozitave të punës, mirëpo vetëm pasi që ta ketë aprovuar rregulloren e re për organizmin e brendshëm dhe sistematizimin e vendeve të punës, ashtu që pozitat e reja të krijuara apo ato ekzistuese duhet të jenë apo klasifikohen në pajtueshmëri me katalogun e vendeve të punës për shërbimin civil, ligjin e pagave për zyrtarët publik dhe ligjit material për shërbimin civil.

Thënë si më lartë, dhe në mbështetje të nenit 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: “ 2.Organi epror, me akt administrativ, do të refuzojë ankesën nëse ankesa është e papranueshme, apo është e pabazuar, në pikëpamjen e ligjshmërisë apo përshtatshmërisë. nën paragrafi “, Kolegji i Këshillit vendosi që ankesën e ankuesit ta refuzoi si të pabazuar, sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa nuk u lëshua në shqyrtimin meritore lidhur me ndryshimin e klasës profesionale të pozitës së ankuesit, pasi që nga arsyetimi i dhënë si më lartë, Kolegji i Këshillit konstatoi se organi i punësimit duhet t'i shtjerrë disa hapa procedural dhe ligjor përpara se të bëjë klasifikimin e vendeve të punës, gjegjësisht hapat e tillë janë parakusht ligjor që organi i punësimit t' kryej, dhe më pastaj të bëjë klasifikimin e vendeve apo pozitave të punës, kurse ankuesit pas përfundimit të këtij procesi, nëse nuk është i kënaqur me përcaktimin e klasës së tij, i lind e drejta në ankesë, pas përfundimit të procedurës së ristrukturimit apo riorganizimit të brendshëm nëse vlerëson se me heshtje apo me akt administrativ i janë cenuar të drejtat nga marrëdhënia e punës.

Andaj, duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1, nën paragrafi 1.1, nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr.08/L-180, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda, A.nr.472/2025, datë 08/05/2025.

Flakron GASHI

Arben MEHMETI

Procesmbajtës

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit M.I;
- Komunës së Obiliqit (Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore), si dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.